



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 5 Akti

Nr. 12 Vendimi

Tiranë, më 23.03.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupës gjyquese të përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)
Brunilda Bekteshi
Etleda Çiftja

Kryesuese
Anëtare
Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, Znj. Anisa Duka, dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, Znj. Elka Ermenkova, sot më datë 23.03.2018, ora 11:00, në katin e dytë, pranë Pallatit të Kongreseve zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Z. FATOS LULO, GJYQATAR PRANË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nr.1137 rep., nr.324 kol., datë 02.03.2018 nga avokat Ardian Visha, me nr. licence 3525.

Çështja u relatua nga komisionerja Etleda Çiftja.

BAZA LIGJORE E PROCEDURËS SË RIVLERËSIMIT:

Nenet 179/b, A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

Pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, Znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, si më poshtë vijon:

RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Zoti Fatos Lulo është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.
2. Në bazë të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë se Z. Fatos Lulo është gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar më datë 6 nëntor 2017 me trupë gjykuese nr. 2, të përbërë nga:

Genta Tafa	Komisionere
Brunilda Bekteshi	Komisionere
Etleda Çiftja	Relatore
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “KLD”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “Komisioni”), me vendimin nr. 1, datë 14.11.2017, të trupës gjykuese nr. 2, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuesin e trupës, Znj. Genta Tafa (Bungo); të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Më datë 08.02.2018, trupa gjykuese, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
6. Më datë 14.02.2018, me anë të postës elektronike, trupa gjykuese njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse

- disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me e-mail; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me e-mail; (iv) përbërjen e trupës gjyquese.
7. Më datë 28.02.2018, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e tij së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.
 8. Më datë 13.03.2018, trupa gjyquese nr. 2, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 21.03.2018, ora 11:00 paradite, te Pallati i Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë.
 9. Më datë 21.03.2018, u zhvillua seanca dëgjimore në mungesë të subjektit të rivlerësimit, por përfaqësuar në seancë dëgjimore me avokat Z. Ardian Visha, me anë të prokurës së përgjithshme Nr.1137 rep., Nr. 324 Kol., datë 02.03.2018, me Nr. Licence 3525.
 10. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupa gjyquese vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, vetëm mbi komponentin e vlerësimit të pasurisë, duke mos vendosur mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.
 11. Ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për Z. Fatos Lulo, merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

12. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 28.02.2018, dhe përfaqësuesit të tij gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (dh) denoncimet nga publiku; (e) faktet e njohura botërisht.

12.1 DEKLARIMI I PASURISË DHE TË ARDHURAVE

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, dorëzuar në ILDKPKI, më datë 30.01.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me pasurinë

- 12.1.1 Apartament banimi + depo + sipërfaqe e azhurnuar 112 m² + 15 m² + 2.5 m², Rr. {*}, fituar me kontratë sipërmarrjeje, datë 08.12.2001 dhe kontratë shitjeje datë 24.03.2014. Me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes. Vlera 50.000 USD, plus shpenzime mobilimi, barabartë me 9.300.000 lekë. Pjesa takuese 50%.
- 12.1.2 Njësi nr. 20 (e konsideruar zyrrë), me sip. 172 m², e ndodhur në godinën nr.{*}, Rruga{*}, fituar me kontratë dhurimi datë 06.12.2011. Vlera 0 (zero) lek. Pjesa takuese 100%.

- 12.1.3** Zyrë (ish avokatie) në Rr. {*} me sipërfaqe 74 m², në përdorim me të drejtë blerjeje, në shumën 13.800.000 lekë. Vlera 0 (zero) lek. Pjesa takuese 0 (zero) %.
- 12.1.4** Llogaria e pagës në “Credins Bank”. Vlera 32.242,45 lekë. Pjesa takuese 100%.
- 12.1.5** Kartë krediti “Visa Classic” në “Credins Bank”. Pjesa takuese 100%.
- 12.1.6** Kartë krediti në “Raiffeisen Bank”. Pjesa takuese 100%.

Deklarimi i të ardhurave

- 12.1.7** Jurist në organe të ndryshme shtetërore në Tiranë, sipas dinamikës së librezës së punës. Shuma: 90.000 lekë.
- 12.1.8** Aktivitet privat me profesion avokat me fillim vitin 1995 - 1999 e më pas në vitet 2002 - 2005. Shuma: 10.500.000 lekë.
- 12.1.9** Dhurim prej 100.000 USD me kontratën nr. 1369 rep., dhe nr. 547 kol., datë 21.08.2008.
- 12.1.10** Anëtar i Gjykatës së Lartë, në vitet 2006 - 2013. Shuma: 11.938.448 lekë.
- 12.1.11** Anëtar i Gjykatës Kushtetuese, nga viti 2013 deri në janar 2017. Shuma: 6.997.637 lekë.

Deklarimi i personave të lidhur/ bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Znj. R.L. Bashkëshortja, Znj. R. L., ka nënshkruar autorizimin e personit të lidhur dhe ka deklaruar se disponon pasuri veçmas, si më poshtë:

Deklarimi i pasurive

- 12.1.12** Apartament banimi + depo, sipërfaqe e azhurnuar 112 m² +15 m² +2.5 m², Rr. {*}, fituar me kontratë sipërmarrjeje datë 08.12.2001 dhe kontratë shitjeje datë 24.03.2014. Me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit si avokat dhe paga. Vlera: 50.000 USD, plus shpenzime mobilimi, barabartë me 9.300.000 lekë. Pjesa takuese 50%.
- 12.1.13** Apartament banimi i privatizuar në vitin 1993 nga shteti, në Rr.{*}, 1+1, me sipërfaqe 68.54 m², Tiranë, në bashkëpronësi me katër anëtarë të familjes së saj gjatë vajtërisë. Vlera: 17.440 lekë. Pjesa takuese 20%.

Deklarimi i të ardhurave

- 12.1.14** Nga viti 1994 deri në 1998, si dhe në vitet 2002 - 2008, punësuar në Akademinë e Shkencave, Qendra e Studimeve Gjeografike, Tiranë. Shuma: 5.997.600 lekë.
- 12.1.15** Nga viti 2014 - 2015, mësuese në shkollën “Faik Konica”, Tiranë. Shuma: 270.000 lekë.
- 12.1.16** Të ardhura nga shitja e, apartament banimi 1+1, Rr.{*}, me sipërfaqe 68.54 m². Shuma: 5.000 USD.

Deklarimi i personave të lidhur/ djalit të subjektit të rivlerësimit, E. L.

- 12.1.17** Depozitë në “Credins Bank”. Të ardhura nga familja. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

Deklarimi i personave të lidhur/ djalit të subjektit të rivlerësimit, E. L.

- 12.1.18** Depozitë në “Credins Bank”. Të ardhura nga familja. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese 100%.

12.1.19 DEKLARIM SHITESË - Subjekti i rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë edhe një deklaratë, e cila në përmbajtjen e saj citon si më poshtë:
“Unë, Fatos Y. Lulo, me detyrë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, duke qenë se jam subjekt i deklaramit të pasurive, si dhe në mbështetje të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të

gjiqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë", shoh të nevojshme të sqaroj nëpërmjet këtij deklarimi, sa më poshtë vijon:

Në deklarin tim të parë, që mban datën 27.11.2004, si rezultat i emërimit tim si anëtar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit,

- 1. Në formularin A-1, faqe 4, te pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to, kam deklaruar apartament banimi me sipërfaqen dhe vlerën përkatëse në Toronto, Kanada, të pahipotekuar;*
- 2. Në formularin A-5, faqe 8, te pjesa likuiditete, kam deklaruar depozitë jashtë vendit 400.000 dollarë kanadezë në Toronto, Kanada;*
- 3. Në formula rin A-8, te detyrime financiare ndaj ... , kam deklaruar marrjen hua të shumës 480.000 dollarë amerikanë motrës sime.*

Në deklarin tim periodik, që mban datën 27.03.2006, si rezultat i emërimit tim si anëtar i Gjykatës së Lartë,

- 1. Në faqen 3 të tij kam deklaruar shitje apartamenti në Toronto, Kanada, si edhe shumën përkatëse;*
- 2. Në faqen 5 të tij kam deklaruar shlyerjen e huas 480.000 dollarë amerikanë, dhënë nga motra ime.*

Sa më sipër, sqaroj se kam dy shtetësi, atë shqiptare dhe atë kanadeze. Në vitin 2004, vit që përkon me deklarin tim të parë, unë kam qenë rezident në të dyja vendet (vërtetohet nëpërmjet taksave të shtetit kanadez) dhe njëkohësisht, së bashku me motrën time, D. L, biznesmene në fushën e ndërtimit në një nga shoqëritë me emër në Shqipëri, menduam të zhvillonim edhe në Kanada biznes së bashku. Për këtë, motra ime D. më dha hua në cash shumën 480.000 dollarë amerikanë (shiko kontratën e huas, me nr. 5120 rep., datë 04.09.2000).

Formulari i deklarimit të parë, mbushur nga unë, datë 27.11.2004, pasqyron mundësinë e blerjes së një apartamenti me ekstremitetet përkatëse në Toronto, pasi unë isha në tratativa për blerjen e tij me agjenci imobiliare, prandaj në formular është shënuar i pahipotekuar, për vetë faktin se akoma nuk ishte blerë.

Për sa më sipër, në pikën 2, nga shuma që unë kisha në dispozicion prej 480.000 dollarësh amerikanë, mendoja të hapja një llogari në bankat në Kanada, në shumën 400.000 dollarë kanadezë. Ky fakt është më se i vërtetë, pasi unë nuk kam vënë asnjë numër llogarie për këtë shumë, pasi nuk ekzistonte të qe bërë kjo transfertë. Duke qenë se unë s'po ndërmerija asnjë veprim në lëvrimin e shumës për blerjen e apartamentit, agjencia imobiliare, ku kisha bërë prenotimin, kreu shitjen e saj në vlerën që unë e kam pasqyruar në deklarin periodik të datës 27.03.2006.

Sa më sipër, është plotësisht e vërtetueshme, nëpërmjet organeve zyrtare financiare kanadeze, që unë asnjëherë nuk kam pasur apartament të blerë në Kanada, si edhe shumën prej 400.000 dollarësh kanadezë në ndonjë llogari bankare në atë vend apo të jetë lëvizur një shumë e tillë nga Shqipëria në Kanada dhe anasjelltas.

Çdo gjë si më lart, e deklaruar nga unë në deklaratën e vitit 2004 dhe 2006, ka ardhur si rezultat i mospasjes së një faqeje ku të deklarohej për prona apo likuiditete, të cilat ishin në pritshmëri ardhjeje për subjektin deklarues. Në këto kushte unë, deklaruesi, u këshillova nga zyrtarët e ILDKPKI-së t'i pasqyroj në deklarinimet e mia, por duke i vënë fjalën 'pa hipotekuar'. Në Kanada, blerja e një prone shoqërohet në mënyrë të menjëhershme me dokumentin hipotekor të pronësisë, gjë që unë nuk e kam pasur ndonjëherë.

Në vitin 2010 apo 2011 (nuk e mbaj mend ekzakt vitin), mua më ra shorti në ILDKPKI për kontroll të thellë. Nga ky organ, jam thirrur nga inspektori dhe kam dhënë shpjegime për gjithçka në lidhje me deklaratën e vitit 2004 dhe atë të vitit 2006, vit në të cilin unë mora postin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Shpjegimet e mia janë të njëjta me të asaj kohe, kur unë jam pyetur nga ILDKPKI -ja. ILDKPKI, mbasi kreu të gjitha veprimet e saj, mendoj se arriti në një konkluzion. Ky konkluzion i saj duhet të ketë qenë në favorin tim, pasi unë kam vazhduar në detyrë që nga ajo kohë dhe deri më sot. Në këto kushte, mendoj se ky objekt

kontrolli është i ezauruar. Sa më lart, deklarohet në vullnetin dhe përgjegjësinë time ligjore”.

12.2 RAPORTI I HOLLËSISHËM DHE I ARSYETUAR I INSPEKTORATIT TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Me shkresën nr. 338, datë 06.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004, me numër indeksi 4175 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2004 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” më datë 30.01.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- 12.2.1 Deklarim i rremë lidhur me burimin financiar që deklarohet se është përdorur për blerjen e apartamentit, me adresë Rr. {*}, Tiranë, blerë në vlerën 9.300.000 lekë, pasi, në deklaratën e interesave private “Para Fillimit të Detyrës, 2004” është deklaruar “*Burimi- blerë me kursimet familjare, plus shitja e banesës së privatizuar*”, ndërsa në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” është deklaruar “*Burimi-me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes*”.
- 12.2.2 Deklarim i rremë dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit, me adresë Rr. {*}, Tiranë, blerë në vlerën 9.300.000 lekë.
- 12.2.3 Deklarim i rremë dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetas D. L për blerjen e asetit njësi, me sip. 172 m², e ndodhur në godinën nr. {*}, Rr.{*}, e cila më pas deklarohet dhuratë subjektit Fatos Lulo.
- 12.2.4 Deklarim i rremë lidhur me asetin ambient zyre, 74 m², Rr.{*} pall. {*}, Tiranë, pasi në deklaratën “Para Fillimit të Detyrës, 2004” është deklaruar vlera 13.800.000 lekë, e pahipotekuar, burimi- blerë nga aktiviteti si avokat. Ndërsa në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” deklarohet në përdorim me të drejtë blerjeje në shumën 13.800.000 lekë.
- 12.2.5 Deklarim i rremë dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të shtetas D. L për blerjen e asetit ambient zyre, 74 m², Rr. {*} pall. {*}, Tiranë, të cilin ia ka lënë në përdorim, me të drejtë blerjeje, subjektit Fatos Lulo.
- 12.2.6 Deklarim i rremë dhe mungesë dokumentacioni ligjor lidhur me të ardhurat nga avokatia për periudhën 1995 - 1999, 2002 - 2005, deklaruar në shumën totale 10.500.000 lekë.
- 12.2.7 Deklarim i rremë dhe mungesë dokumentacioni ligjor, lidhur me burimin financiar të shtetas D. L për dhurimin e bërë në shumën 100.000 USD, si dhe fshehje të pakësimit ndër vite të shumës 100.000 USD, e cila është përdorur për jetesë, arsimime dhe të tjera të kësaj natyre, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, sipas deklaramit të subjektit.

- 12.2.8** Deklarim i rremë lidhur me asetin apartament banimi, në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar, blerë nga aktiviteti si avokat, pasi ky aset nuk ka ekzistuar ndonjëherë.
- 12.2.9** Deklarim i rremë lidhur me depozitën jashtë vendit, në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me burim nga puna në emigracion, pasi kjo depozitë nuk ka ekzistuar ndonjëherë.
- 12.2.10** Deklarim i rremë dhe mungesë dokumentacioni ligjor, lidhur me dhënien e huas në shumën 480.000 USD, nga motra D. L, pasi nuk vërtetohet mundësia financiare e huadhënësit, si dhe deklarim i rremë lidhur me qëllimin dhe përdorimin e kësaj shume.
- 12.2.11** Deklarim i rremë lidhur me shitjen e apartamentit të banimit, me sip. 150 m², në Toronto, Kanada, në shumën 160.000 CAD, pasi ky apartament nuk ka ekzistuar ndonjëherë.
- 12.2.12** Deklarim i rremë lidhur me mbylljen e depozitës në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me qëllim shlyerjen e huas, pasi kjo depozitë nuk ka ekzistuar ndonjëherë.
- 12.2.13** Deklarim i rremë lidhur me shlyerjen e huas motrës D. L, në shumën 480.000 USD, deklaruar me shitjen dhe moshapjen e biznesit të planifikuar, nga puna, dhe mbyllja e depozitës në Toronto, Kanada, depozitë e cila nuk ka ekzistuar ndonjëherë.
- 12.2.14** Mungesë burimesh të ligjshme financiare për shumat 160.000 CAD dhe 400.000 CAD, të deklaruara nga shitja e një shtëpie që nuk ka ekzistuar ndonjëherë dhe nga mbyllja e një depozite që nuk ka ekzistuar ndonjëherë, në Toronto, Kanada.
- 12.2.15** Dhe, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, ka konstatuar se:
- i. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
 - ii. Është kryer deklarim i rremë;**
 - iii. Nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesave.**

12.3 HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, si dhe verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, si dhe deklaramet e bëra me anë të postës elektronike e-mail, Komisioni ka administruar prova shpresore nga: *Institucionet financiare bankare dhe jobankare; Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë; Instituti i Sigurimeve Shoqërore; Qendra Kombëtare e Biznesit; Ministria e Drejtësisë; Noteri Publik*, për dokumentacion në lidhje me subjektin, dhe *Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; Prokuroria e Përgjithshme*, që vërtetojnë veprime dhe fakte për realizimin e hetimit sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilin nga asetet dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, konstatohet se:

- 12.3.1** Për apartamentin e banimit + depo + sipërfaqe e azhurnuar, 112 m² + 15 m² + 2.5 m², Rr. {*}, fituar me kontratë sipërmarrjeje datë 08.12.2001 dhe kontratë shitjeje datë 24.03.2014, me burim të deklaruar të të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes. Vlera 50.000 USD, plus shpenzime mobilimi, barabartë me 9.300.000 lekë, dhe

Burimi i krijimit të këtij aseti: Të ardhurat në shumën prej 10.500.000 lekësh, deklaruar si të ardhura nga aktiviteti privat me profesion “Avokat” me fillim nga viti 1995 - 1999, e më pas në vitet 2002 - 2005.

- a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:
- i. ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. 42095/1, datë 05.12.2017 dhe shkresën me nr. 42646, datë 06.12.2017, si edhe 23 shkresa nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku konfirmohet se në emër të subjektit ekziston prona e sipërpërmendur, e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në vitin 2014.
 - ii. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017, konfirmon se Z. Fatos Lulo, nga aktiviteti privat “Avokat” shprehet se nuk ka të ardhura të deklaruara për efekt pagimi tatimesh deri në vitin 2001, vit kur deklarohet se është blerë shtëpia. Pra, këto të ardhura rezultojnë të jenë “0” (zero) lek. Sipas kësaj shkrese, rezulton se gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij si avokat, Z. Lulo ka xhiro të realizuar, për periudhën janar - dhjetor 2004, në shumën 1.170.100 lekë dhe qarkullim të deklaruar për janar-dhjetor 2005 në shumën 3.000.000 lekë.
 - iii. Akademia e Shkencave, me shkresën nr. 63/1 prot., datë 27.01.2017, dhe vërtetimi nga Qendra e Studimeve Gjeografike, nr. ekstra prot., datë 11.11.2008, ku rezulton se për periudhën deri në vitin 2001 të ardhurat janë në shumën prej 2.000.000 lekësh (duke marrë si pagë referuese pagën e deklaruar të vitit 2005, pasi Akademia e Shkencave ka dërguar shumën totale nga viti 1994 - 2008 prej 5.997.600 lekësh).
- b. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 08.02.2018, të trupës gjyquese nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe, më datë 14.02.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë aset/pronë kanë nivelin e provueshmërisë, duke i dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht në lidhje me këtë aset, duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton:
- i. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit referuar “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”;
 - ii. Ka mospërputhje deklarimi për burimin e të ardhurave midis deklaratës së interesave private, “Para Fillimit të Detyrës, 2004”, ku është thënë se: “...*Burimi është blerë nga kursimet familjare, plus shitja e banesës së prindërve*”, ndërsa në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” është thënë: “*Burimi –me të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe të ardhurat e bashkëshortes*”.
 - iii. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat nga avokatia, për periudhën 1995 - 1999, 2002 - 2005, deklaruar në shumën 10.500.000 lekë. (Maksimalisht të ardhurat e realizuara nga avokatia janë 4.170.100 lekë).
- c. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 28.02.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij/provat në lidhje me këtë aset, si më poshtë vijon:
- i. Në apartamentin e fituar me kontratën e shitjes, datë 24.03.2014, ku jetonte që nga viti 2001, vërtetuar edhe me kontratën e sipërmarrjes datë 08.12.2001, të ndodhur midis rrugës {*} dhe rrugës {*}, por që regjistrimi në

- Hipotekë është bërë në vitin 2014, duke pasur parasysh situatën e regjistrimeve të pronave në Shqipëri.
- ii. Burimi financiar që mbulon blerjen e kësaj prone është përballuar nga aktiviteti si avokat, si dhe të ardhurat e bashkëshortes. Për sa më sipër, aktivitetin e ligjshëm dhe fitimprurës e vërteton nëpërmjet vendimeve të gjykatës për regjistrimin dhe zhvillimin e aktivitetit të avokatit të vitit 1995, atë të vitit 1997 dhe të vitit 2004. Njëkohësisht, nga pagesa e sigurimeve shoqërore të kryera dhe që mbulojnë nga viti 1994 deri në vitin 2003, si edhe paga e bashkëshortes, e vërtetuar nëpërmjet shkresave zyrtare.
 - iii. Subjekti pranon se nuk ka dokumentacion justifikues që të vërtetojë se janë deklaruar të ardhurat dhe janë paguar tatimet, por sqaron se nuk mund të bjerë barra mbi mungesën e dokumentacionit nga Drejtoria Rajonale Tatimore. Kjo drejtori, më datë 23.01.2017, lëshon shkresë ku vërteton se subjekti i rivlerësimit është subjekt i tatimeve për vitet 2004 - 2005 dhe, me kërkesë të përsëritur nga ai, për periudhën 1994 – 2013, dhe më datë 27.01.2017 i dërgohet përgjigja e dytë që arkivi nuk disponon dokumentacion.
 - iv. Subjekti më tej thekson se barra e tij e provës bëhet brenda kornizave ligjore, ashtu siç parashikohet nga neni 17 i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku afati i ruajtjes së dokumenteve nga ana e tatim-taksave është 10 vjet. Neni 48 i ligjit nr. 9930, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, ka parashikim deklarimi nga deklarata e fundit vetëm 5 vite. Tej kufijve të këtyre afateve, subjekti thotë që s’ka se çfarë të provohet.
 - v. Më tej, subjekti thotë se është e ditur dhe e sanksionuar në ligj që regjistrimi për zhvillimin e një aktiviteti në gjykatë shoqërohet më pas me regjistrim në zyrat e Tatimeve përkatëse. Çdo veprim i kundërt shoqërohet me sanksione deri në heqjen e licencës përkatëse, gjë që s’ka ndodhur me subjektin. Pra, subjekti thotë se ka qenë i regjistruar konform të gjitha ligjeve në fuqi dhe se të ardhurat e tij mbulonin shumë më tepër se blerja e një apartamenti që ai ka dhe sot.
 - vi. Për sa u përket mospërputhjeve në deklaratimet e tij, subjekti nuk konstaton të ketë të tilla dhe se Komisioni nuk saktëson se ku janë këto mospërputhje që subjekti të mund të përgjigjej.
 - vii. Subjekti dërgoi së bashku me shpjegimet dhe 9 (nëntë) dokumente provuese për të provuar sa më lart shpjegoi: Dokument 1 “Vendim gjykate 1995”; Dokument 2 “Vendim gjykate 1997”; Dokument 3 “Vendim gjykate 2004”; Dokument 4 “Vërtetim sigurimesh shoqërore”; Dokument 5 “Vërtetim pune, Akademia e Shkencave, R. L; Dokument 6 “Vërtetim page, R. L; Dokument 7 “Përgjigje, Tatimet, 23.01.2017”; Dokument 8 “Kërkesë e përsëritur Tatimeve”; Dokument 9 “Përgjigje, Tatimet, 27.01.2017”, dokumente të cilat i janë bashkëlidhur dhe “Deklaratës së Pasurisë, Vetting 2017”.

d. Shpjegimet e përfaqësuesit ligjor të subjektit, Z. Ardian Visha, për këtë aset gjatë seancës dëgjimore, zhvilluar më 21.03.2018:

- i. Fakti që edhe për rregullime ligjore kohëpërcaktuese të ruajtjes së dokumentacionit, Drejtoria Rajonale Tatimore nuk ka provuar të ardhurat e Z. Lulo nga puna e tij si avokat për periudhën e viteve ‘90 kryesisht, nuk legjitimon konkluzionin e ILDKPKI-së se të ardhurat nga aktiviteti i tij privat për këtë periudhë janë zero lek. Po kështu, nuk mundet që mbi këtë bazë të rrjedhë logjikisht i ashtuquajturi nga ILDKPKI deklarim i rremë i Z. Lulo apo edhe mungesa e burimit të ligjshëm të apartamentit, me adresë në rrugën {*}, Tiranë (kujojmë jo pa qëllim që ky është edhe sot apartamenti i vetëm ku banon Z. Lulo dhe familja e tij, blerë para se sa ai të emërohej gjyqtar).

- ii. Neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016 rregullon rastet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin justifikues. Ka të paktën dy shkresa, ku vetë Z. Lulo i drejtohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me qëllim marrjen e të dhënave që mund të ruheshin ende prej kësaj zyre, e që provojnë të ardhurat e ligjshme të punës së tij si avokat. Këto akte, jo vetëm dëshmojnë përpjekjet ekstreme për të realizuar me prova pretendimet e ligjshme e të drejta për kohën që është aktivuar si avokat, por njëkohësisht, për shkak të kualitetit të përgjigjeve e përmbytjes së tyre, tregojnë mosruajtjen e të dhënave e dokumenteve pranë institucionit tatimor Tiranë.
- iii. Mbi çdo standard aktiviteti prej avokati për periudhën kohore të viteve '90, dëshmohet lehtësisht mundësia e nxjerrjes së të ardhurave për disa vite, legjitimuese të shifrës prej 50.000 dollarësh, me të cilat është blerë banesa ku dhe sot jeton Z. Lulo me bashkëshorten.

e. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

12.3.2 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, (iv) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike; (v) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe avokati i tij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, arsyeton se:

12.3.3 Në lidhje me dokumentacionin justifikues ligjor të burimit të deklaruar të të ardhurave, që ka shërbyer për blerjen e këtij aseti, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe deklarim të rremë, provuar kjo me:

- i. Shkresën nr. 42095/1, datë 05.12.2017 dhe shkresën me nr. 42646, datë 06.12.2017, dërguar nga ZVRPP Tiranë, ku konfirmohet se në emër të subjektit ekziston prona e sipërpërmendur e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në vitin 2014.
- ii. Shkresën nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, që konfirmon se Z. Fatos Lulo, nga aktiviteti privat “Avokat” ka xhiro të realizuar, për periudhën janar - dhjetor 2004, në shumën 1.170.100 lekë dhe qarkullim të deklaruar për janar-dhjetor 2005 në shumën 3.000.000 lekë, ndërsa për periudhën 1995 - 2001 (vit kur deklarohet se është blerë shtëpia) nuk janë raportuar të ardhura të deklaruara për efekt pagimi tatimesh nga ky aktivitet. Si rrjedhojë, të ardhurat e ligjshme të subjektit për këtë periudhë rezultojnë të jenë “0” (zero) lek, çka do të thotë se subjekti nuk ka dokumentacion justifikues ligjor për blerjen e këtij aseti në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës, që përcakton se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*.
- iii. Shkresën e Akademisë së Shkencave nr. 63/1 prot, datë 27.01.2017 dhe vërtetimi nga Qendra e Studimeve Gjeografike, nr. Ekstra prot., datë 11.11.2008, ku rezulton se për periudhën deri në vitin 2001 të ardhurat janë në shumën prej 2.000.000 lekësh (Duke marrë si pagë referuese pagën e deklaruar të vitit 2005, pasi Akademia e Shkencave ka dërguar shumën totale nga viti 1994 - 2008 prej 5.997.600 lekësh).

12.3.4 Bazuar në të ardhurat e deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrime, është bërë një analizë financiare, e cila pasqyron mungesën e të ardhurave të ligjshme për të paguar vlerën e asetit/apartamentit, si më poshtë:

Vitet e punës	Të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit	Të ardhurat e ligjshme të bashkëshortes së subjektit
1994	0 (zero)	549 780
1995	0 (zero)	543 235
1996	0 (zero)	543 235
1997	0 (zero)	274 890
1998	0 (zero)	543 235
1999	0 (zero)	274 890
2000	0 (zero)	
2001		
Total	0 Lekë	2.731.265 Lekë

Tabelë 1.- Të ardhurat për blerjen e apartamentit në vitin 2001

Pra, vlera totale e të ardhurave të ligjshme nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është 2.731.265 (dy milionë e shtatëqind e tridhjetë e një e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, pa zbritur këtu shpenzimet e domosdoshme për jetesë.

12.3.5

Në lidhje me burimin financiar, që deklarohet se është përdorur për blerjen e këtij apartamenti, konstatohet se ka deklarim të rremë, provuar kjo me krahasimin midis deklaratës së interesave private “Para Fillimit të Detyrës, 2004”, me nr. indeksi 04175, datë 27.11.2004, ku është deklaruar “*Burimi- blerë me kursimet familjare, plus shitja e banesës së privatizuar*”, ndërsa në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting 2017”, me numër indeksi 04175/2017, dorëzuar më 30.01.2017, është deklaruar “*Burimi- me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes*”. Këto deklarata, ajo e vitit 2004 dhe 2017, përbëjnë provë, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, i cili specifikon se: “*Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni ...*”.

12.3.6

Për sa i përket deklaramit të subjektit se ai ka filluar jetesën në vitin 2001 në këtë apartament, Komisioni konstaton se subjekti ka bërë deklarim të rremë në lidhje me kohën kur ka filluar të jetojë në këtë apartament për këto arsye:

- i. Kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar më datë 08.12.2001 dhe subjekti asokohe deklaronte se ishte rezident në Kanada, siç edhe provohet nga deklaramet e subjektit me anë të postës elektronike.
- ii. Kontrata me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) është lidhur më datë 20.02.2003, provuar kjo nga sistemi i OSHEE-së.

12.3.7

Në lidhje me mënyrën e pagesës së apartamentit, Komisioni konstaton se subjekti ka bërë deklarim të rremë për këto arsye:

- i. Në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, subjekti i ka bashkëngjitur kontratës së sipërmarrjes dy mandate arkëtimi për të vërtetuar që ka bërë pagesën pranë shoqërisë {*} sh.p.k., por në kontratën e sipërmarrjes së datës 08.12.2001, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë {*} sh.p.k., është përcaktuar se pagesa do të bëhet me dy këste dhe do të derdhet në llogarinë bankare të sipërmarrësit me nr. 3002/116 (Banka Kombëtare Tregtare), sipas nenit 3 të po kësaj kontrate.
- ii. Më tej, në kontratën e shitjes me nr. 1514 rep., nr. 748 kol., datë 24.03.2014, të të njëjtit apartament, shoqëria {*} sh.p.k., në cilësinë e shitësit, deklaroi se ua shet blerësve, Z. Fatos Lulo e Znj. R. L, apartamentin... me një vlerë totale prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) USD, shumë e cila është paguar në llogarinë bankare të shoqërisë para nënshkrimit të kësaj kontrate.

- 12.3.8** Për sa i përket argumentimit të subjektit se nuk mund të provojë të ardhurat e realizuara nga viti 1994 - 2003, pasi Drejtoria e Tatimeve, më datë 27.1.2017, i dërgon përgjigje që arkivi nuk disponon dokumentacion dhe se subjekti është në pamundësi të provojë të kundërtën, pasi barra e tij e provës bëhet brenda kornizave ligjore, ashtu siç parashikohet nga neni 17 i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku afati i ruajtjes së dokumenteve nga ana e tatim-taksave është 10 vjet. Neni 48 i ligjit nr. 9930, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, ka parashikim deklarimi nga deklarata e fundit vetëm 5 vite, Komisioni arsyeton se mosparaqitja e këtyre dokumenteve justifikuese nuk është për shkaqe të arsyeshme, pasi:
- i. Përgjigjja e ardhur nga Drejtoria e Tatimeve, se nuk disponon dokumentacion, nuk do të thotë se Drejtoria e Tatimeve nuk disponon dokumentacion në arkiv për vitet respektive, por ajo nuk disponon asnjë dokument/deklarim të bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë këtyre viteve, pasi subjekti nuk është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore për të deklaruar të ardhurat e tij. Në të kundërt, subjekti i rivlerësimit do t’i kishte vënë në dispozicion Komisionit dokumentin që vërteton regjistrimin pranë Tatimeve, “Kodin fiskal” që të vërtetonte se ka qenë i regjistruar, në përputhje me ligjin nr. 7677, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi fitimin”, i shfuqizuar me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar”.
 - ii. Ndërsa baza ligjore që është përdorur për afatin e ruajtjes së dokumenteve, neni 17 i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nuk është relevante, pasi fusha e zbatimit të këtij ligji janë njësitë ekonomike të vendosura në Republikën e Shqipërisë, që kanë qëllime fitimprurëse, përfshirë institucionet financiare dhe shoqëritë kontrolluese, pavarësisht nga forma e tyre juridike ose nga kërkesat e veçanta ligjore, që mund të zbatohen ndaj tyre, në përputhje me nenin 2 të po këtij ligji.
- 12.3.9** Për sa më lart, argumenti se subjekti është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive nuk qëndron, pasi subjekti i rivlerësimit nuk vërtetoi që dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, sipas pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Si rrjedhojë, Komisioni vendosi që mosparaqitja e dokumentacionit justifikues është pa shkaqe të arsyeshme.
- 12.3.10** Në këto kushte, duke analizuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” të faktit të blerjes së shtëpisë “*me të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe paga e bashkëshortes*”, raportin e ILDKPKI-së, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe avokatit të tij, përgjigjet e pyetësorit, si dhe provat shkresore të administruara nga ana e Komisionit, konkludohet se subjekti i rivlerësimit, së bashku me bashkëshorten e tij, nuk kanë pasur të ardhura financiare të ligjshme, d.m.th., nuk janë deklaruar te Drejtoria e Tatimeve dhe si rrjedhojë nuk kanë paguar detyrimet tatimore për blerjen e shtëpisë në shumën prej 9.300.000 lekësh në total, ku 50.000 USD (e konvertuar me kursin përkatës të Bankës së Shqipërisë, ka vlerën 5.434.500 lekë) për shtëpinë dhe 3.865.500 lekë për mobilim.
- 12.3.11** Referuar pikës 3 të nenit 61, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- 12.3.12** Për dhuratat dhe huatë e dhëna nga motra e subjektit të rivlerësimit, Znj. D. L:
- i. Për njësinë nr. 20 (e konsideruar nga subjekti si zyrë), me sip.172 m², me vlerë 120.000 euro, e ndodhur në godinën nr. {*}, Rruga{*}, fituar me kontratë dhurimi, datë 06.12.2011.
 - ii. Dhurimi i një shume prej 100.000 USD me kontratën nr.1369 rep., dhe nr. 547 kol., datë 21.08.2008, nga Znj. D. L, e konsumuar në vitet 2008- 2016.

- iii. Huan në *cash*, në shumën prej 480.000 USD, me anë të kontratës së huasë nr. 5120, datë 04.09.2000.
- iv. Kontratën e huapërdorjes, datë 22.10.2002, për zyrën (e ish avokatisë) në Rr. {*}, me sipërfaqe 74 m², në përdorim me të drejtë blerjeje në shumën 13.800.000 lekë.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet dhe vetë subjekti:

- i. Nga ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. 42095/1, datë 05.12.2017, dhe shkresën me nr. 42646, datë 06.12.2017, është konfirmuar se në emër të subjektit ekziston prona e sipërpërmendur, e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.
- ii. Kontratë premtim dhurimi nr. 1661 rep., nr. 622 kol., datë 15.03.2009, ku konfirmohet se vlera e këtij apartamenti është 120.000 euro. Në këtë kontratë citohet se: *Znj. D. L i ka shlyer të gjitha detyrimet me shoqërinë {*}, pra i ka paguar kësaj shoqërie shumën 120.000 euro.*
- iii. Drejtoria e Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017, konfirmon se Znj. D. L është administratore në 4 shoqëri, nga të cilat ka pasur 0 (zero) xhiro, 0 (zero) fitim dhe nuk ka shpërndarë dividendë;
- iv. Me shkresën e ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me nr. 729-5/2, datë 13.12.2017, pasqyrohen sigurimet shoqërore që ka paguar Znj. D. L, që fillojnë nga viti 2012 dhe që vërteton se paga bruto për të cilën subjekti paguan sigurime shoqërore është 80.000 lekë.
- v. Shkresa me nr. 174/2, datë 17.01.2018, nga notere M. Sh., me nr. 174 datë 08.01.2018, ku dërgohen kopje të kontratave të dhurimit dhe dokumenteve bashkëngjitur, me anë të së cilës vërtetohet se çmimi i blerjes së zyrës 174 m² është 120.000 euro.
- vi. Kontratë premtim dhurimi nr. 1661, rep., nr. 622 kol., datë 15.03.2009, ku Znj. D.L pranon t'i dhurojë Z. Fatos Lulo një ambient me adresë Rruga{*}, Tiranë. Kontrata citon: *Znj. D.L i ka shlyer të gjitha detyrimet me shoqërinë {*}, pra i ka paguar kësaj shoqërie shumën 120.000 euro.*
- vii. Dy kontratat e sipërmarrjes për ndërmjetësim lelesh ndërtimi lidhur midis shoqërisë {*} dhe Znj. D. L nuk provojnë se sa kanë qenë përfitimet në asete në natyrë ose në likuiditete të Znj. D. L. Gjithashtu, është i paqartë përfitimi në masën 33.3% i fitimit të shoqërisë {*} nga Znj. D.L (cituar në kontratat e ndërmjetësimit), pasi kjo e fundit nuk është aksionere në këtë shoqëri, por paraqitet vetëm si inxhinierë.
- viii. Kontratë huapërdorjeje, e datës 22.10.2002, për zyrën (e ish avokatisë) në Rr. {*}, me sipërfaqe 74 m², në përdorim me të drejtë blerjeje, në shumën 13.800.000 lekë.
- ix. Kontratë huaje në *cash* në shumën prej 480.000 USD, me nr. 5120, datë 04.09.2000.
- x. Përgjigjen e subjektit me anë të postës elektronike, më datë 07.02.2018, në bazë të kërkesës së Komisionit që të deklarojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive: (i) Njësisë nr. 20, me sipërfaqe 172 m², e ndodhur në godinën nr. {*}, Rruga {*}, e dhuruar nga motra e subjektit në vlerën prej 120.000 eurosh; dhe (ii) Shumën prej 100.000 USD, të dhuruar përsëri nga motra e subjektit.

b. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 08.02.2018, të trupës gjyquese nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe, më datë 14.02.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë

aset/pronë kanë nivelin e provueshmërisë duke i dërguar subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit kryesisht në lidhje me këtë aset, duke njoftuar subjektin se i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë rezulton:

- i. Ka mungesë dokumentacioni ligjor lidhur me mundësinë/burimin financiar të shtetases D. L për blerjen e asetit zyrë, me sip. 172 m², në shumën prej 120.000 eurosh (çmimi referuar aktmarrëveshjes nr. 8394 rep., nr. 1776 kol., datë 16.07.2008), e cila më pas ia ka dhuruar Z. Fatos Lulo.
- ii. Ka mospërputhje deklarimi për vlerën e dhuratës midis deklaratës së interesave private “Para Fillimit të Detyrës, 2004” (faqja 6, të dhënat konfidenciale) dhe “Deklaratës së Pasurisë, Vetting”.
- iii. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor nga ana e dhuruesit lidhur me burimin financiar të shtetases D. L, për dhurimin e bërë në shumën 100.000 USD.
- iv. Nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit pakësimi ndër vite i shumës 100.000 USD, ose ku është përdorur kjo shumë dhe si.
- v. Ka mospërputhje në lidhje me pronësinë dhe burimin e asetit ambient zyre, 74 m², Rr. {*}, pall. {*}, Tiranë, pasi në deklaratën “Para Fillimit të Detyrës, 2004” është deklaruar vlera 13.800.000 lekë, e pahipotekuar, burimi- blerë nga aktiviteti si avokat, ndërsa në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” deklarohet në përdorim me të drejtë blerjeje në shumën 13.800.000 lekë.
- vi. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor nga ana e dhuruesit, shtetases D. L, lidhur me burimin financiar të huas në cash, në shumën prej 480.000 USD, me anë të kontratës së huas nr. 5120, datë 04.09.2000.

c. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 28.02.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij/provat në lidhje me këtë aset si më poshtë vijon:

- i. Znj. D. L ka përfituar 33.3%, duke ndërmjetësuar 12 leje ndërtimi nëpërmjet kontratave sipërmarrëse që mbajnë datat 04.12.2000 dhe 27.02.2006 dhe që i ka marrë përfitimet e saj në natyrë dhe likuiditete (para cash) nga shoqëria {*}. Më tej, ai sqaron se shoqëria {*} ka marrë përsipër shlyerjen e gjitha detyrimeve ndaj shtetit (shih kontratat për ndërmjetësim datë 04.02.2000 dhe datë 27.02.2006 bashkëngjitur). Për këtë janë siguruar disa bilance të shoqërisë {*} të viteve 2004, 2005, 2006, 2007, që janë dërguar me e-mail.
- ii. Më pas, subjekti ka shpjeguar se motra e tij, Znj. D. L, ka kryer dhe shitblerje me pronat e përfituara prej saj, ku dy të tilla i ka dërguar me e-mail (Kontratë shitjeje pasurie, datë 24.10.2008, dhe kontratë shitjeje pasurie, datë 02.06.2016), si dhe përfitime nga qiradhënia e këtyre apartamenteve.
- iii. Për sa u përket mospërputhjeve në deklaratimet e tij, subjekti nuk konstaton të ketë të tilla dhe se Komisioni nuk saktëson se ku janë këto mospërputhje që subjekti të mund të përgjigjej. Subjekti ka bashkëngjitur 9 dokumente për të provuar sa më lart.
- iv. Për zyrën (e ish avokatisë), ndodhur në Rr. {*}, me sipërfaqe 74 m², në përdorim me të drejtë blerjeje, në shumën 13.800.000 lekë, subjekti sqaron se: E ka deklaruar në vitin 2004, por ajo ka qenë pasuri në përdorim dhe është detyrim ligjor që pasuritë në përdorim të deklaroheshin nga subjekti dhe se çmimi i vendosur në deklaratën e vitit 2004 përfaqëson vlerën në qoftë se subjekti do ta blinte këtë pasuri nga aktiviteti i tij si avokat. Subjekti ka dërguar me e-mail

- kontratën e huapërdorjes, datë 22.10.2002, nënshkruar midis tij dhe së motrës, Znj. D. L.
- v. Për dhurimin prej 100.000 USD, me kontratën nr. 1369 rep., dhe nr. 547 kol., datë 21.08.2008, me kontratën nr. 1369 rep., nr. 547 kol., datë 21.08.2008, nga Znj. D.L, e konsumuar në vitet 2008 - 2016, subjekti sqaron se: provat për këtë dhurim në lidhje me burimin e të ardhurave janë të njëjtat me ato të sqaruara më lart për njësinë/zyrën nr. 20, me sipërfaqe 172 m², dhe se pakësimi i kësaj shume të dhuruar sipas subjektit nuk duhej të deklarohet në deklaratën e mëpasshme.

d. *Dokumente dhe shpjegimet e dhëna nga përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit, Z. Ardian Visha, gjatë seancës dëgjimore, zhvilluar më 21.03.2018, për të ardhurat e Znj. D. L për të justifikuar dhuratat dhe huat e dhëna subjektit të rivlerësimit:*

- i. Kopje të nxjerra nga sistemi mbi deklarimet individuale vjetore të të ardhurave të shtetases D. Y. L., për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ku vetëm tatimi i paguar tejkalon disa herë dhuratën për vëllain e saj.
- ii. Akt noterial (kopje autentike dhe e noterizuar) i datës 15.03.1997, ku zoti Lulo dhe bashkëshortja i dhurojnë së motrës, Znj. D. L, apartamentin e prindërve të tyre të ndjerë. Vlera e këtij akti qëndron në domethënie e qëndrueshmërisë, reciprocitetin e vëllazërisë së shëndetshme mes tyre.
- iii. Kontratë huapërdorjeje (kopje autentike dhe e noterizuar) pa kundërshtpërblim e datës 22.10.2002, mes Znj. D. L dhe Z. Fatos Lulo, sa i takon ambientit me sip. 74 m², të përdorur si zyrë nga avokati për kohën, Z. Fatos Lulo.
- iv. Kontratë sipërmarrjeje e datës 04.10.2000, mes shoqërisë {*} dhe shtetases D. L, ku kjo e fundit gëzon të drejtën e përfitimit dhe të tërheqjes së 33.3 % të bilancit pozitiv të shoqërisë. Të gjitha detyrimet me shtetin merren përsipër dhe janë paguar nga shoqëria{*}.
- v. Kontratë tjetër sipërmarrjeje, sërish mes të njëjtave palë, e datës 27.02.2006, që provon përfitimin e drejtpërdrejtë të 200.000 dollarëve amerikanë nga Znj. D. L., krahas ruajtjes së kuotës përfituese prej 33.3 % për 4 objekte të ndërtuara tashmë nga e njëjta firmë.
- vi. Dy kontrata shitblerjeje me përkatësisht palë shitëse Znj. D. L, të përzgjedhur enkas nga ana jonë dhe të provuara si të realizuara gjegjësisht më datë 02.06.2006 dhe 24.10.2008, ku bashkërisht Znj. D. L përfiton ligjshëm shumën prej 664.000 eurosh. Edhe vetëm kjo shumë është mjaftueshëm justifikuese e ligjshmërisë krahas mundësisë objektive të dhurimit ndaj vëllait.
- vii. Në lidhje me huan prej 480.000 USD, avokati i subjektit të rivlerësimit pretendon se: Mbi përpjekjen për të hapur dhe zhvilluar një biznes në Kanada, subjekti ka shpjeguar e provuar marrjen hua nga e motra të një shume prej 480.000 dollarësh amerikanë (*Shih për këtë kontratën e huas me nr. 5120, datë 04.09.2000, e ndodhur në dosjen tuaj*). Duke qenë se në këtë periudhë ai ishte rezident dhe taksapagues në të dyja shtetet, synonte me këtë shumë të realizonte blerjen e një banese dhe hapjen e një llogarie bankare në Kanada, në mbështetje të një biznesi.
- viii. Për shkak të detyrimit deklarues të vitit 2004, pasi Z. Lulo u zgjodh anëtar i KKRT-së, i këshilluar nga punonjës të institucionit të deklarimit, tek ka treguar këtë qëllim të marrjes së huas, ka pohuar prenotimin e një banese, duke shënuar vlerën e treguar nga agjencia imobiliare në Kanada, krahas depozitës që synonte të hapte atje. I gjithë ky projekt mbeti i tillë dhe i perealizuar ndonjëherë.
- ix. Për këtë arsye vendosi kthimin e borxhit teorik të së motrës, duke lejuar agjencinë imobiliare të shesë për llogari të të tretëve banesën e prenotuar. Mbi sa më lart, tej faktit që ky raport është para emërimit gjyqtar të Z. Lulo, i dokumentuar për pjesën e huas dhe i kontrolluar nga ILDKPKI-ja, e vërteta është tërësisht e kundërta nga sa pretendon për deklarim të rremë i njëjti institucion sot, post 14 vite.

12.3.13 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Vlerësimit Kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe avokati i tij gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

12.3.14 Në lidhje me dokumentacionin justifikues ligjor të burimit të deklaruar të të ardhurave që ka shërbyer për (i) blerjen e asetit zyrë, me sip. 172 m², me vlerë 120.000 (njëqind e njëzet mijë) euro nga Znj. D. L, ku më pas i dhurohet subjektit Fatos Lulo; (ii) dhurimin e shumës prej 100.000 (njëqind mijë) dollarësh amerikanë për shkollimin e fëmijëve; (iii) zyrën prej 74 m² dhënë me kontratë huapërdorje subjektit të rivlerësimit me të drejtë parablerjeje në shumën prej 13.800.000 lekësh; si dhe (iv) shumën prej 480.000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) USD dhënë hua subjektit të rivlerësimit nga motra e tij, Znj. D. L, Komisioni konstaton se ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e këtyre të ardhurave nga Znj. D. L dhe deklarim të rremë, provuar kjo me:

- i. Shkresë nr. 42095/1, datë 05.12.2017, dhe shkresë nr. 42646, datë 06.12.2017, dërguar nga ZVRPP Tiranë, ku konfirmohet se në emër të subjektit ekziston aseti zyrë, me sipërfaqe 172 m², e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në vitin 2012.
- ii. Kontratë premtim dhurimi, nr. 1661 rep., nr. 622 kol., datë 15.3.2009, ku Znj. D.L pranon t'i dhurojë Z. Fatos Lulo një ambient me adresë Rruga {*}, Tiranë. Kontrata citon: *Znj. D. L i ka shlyer të gjitha detyrimet me shoqërinë {*}, pra i ka paguar kësaj shoqërie shumën 120.000 euro që në vitin 2009.*
- iii. Kontratë sipërmarrjeje, duke ndërmjetësuar për nxjerrje lejesh ndërtimi nr. 7740 rep., nr. 2916 kol., datë 4.12.2000.
- iv. Kontratë sipërmarrjeje, duke ndërmjetësuar për nxjerrje lejesh ndërtimi dhe ndihmë ndërmjet{*} sh.p.k., dhe Znj. D. L, nr. 1418 rep., nr. 523 kol., datë 27.02.2006.
- v. Shkresë nr. 66148/1 prot., datë 19.12.2017, dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, që konfirmon se:
 - Znj. D. L është regjistruar si administratore dhe ortakë me 33.33% të kuotave të shoqërisë në subjektin {*} sh.p.k., dhe nga të dhënat financiare për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 e 2014 rezulton se shoqëria ka pasur 0 (zero) xhiro, 0 (zero) fitim dhe nuk ka shpërndarë dividendë për këto vite.
 - D. Y. L. është regjistruar si administratore dhe ortakë me 33.33 % të kuotave të subjektit {*} sh.p.k., dhe nga të dhënat financiare për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 rezulton se shoqëria ka pasur 0 (zero) xhiro, 0 (zero) fitim për vitet 2007, 2010, 2011, 2012 dhe me humbje për vitet 2008, 2009 dhe nuk ka shpërndarë dividendë për këto vite.
 - D. Y. L është regjistruar si administratore dhe ortakë me 33.33 % të kuotave të subjektit {*} sh.p.k., dhe nga të dhënat financiare për vitet 2007, 2008, 2009 rezulton se shoqëria ka pasur 0 (zero) xhiro, 0 (zero) fitim dhe nuk ka shpërndarë dividendë për këto vite.
 - D. Y. L është regjistruar si administratore dhe ortakë me 33.33 % të kuotave të subjektit {*} sh.p.k., dhe nga të dhënat financiare për vitet 2008,

2009 rezulton se shoqëria ka pasur 0 (zero) xhiro, 0 (zero) fitim dhe nuk ka shpërndarë dividendë për këto vite.

- 12.3.15** Bazuar në provat e administruara, konstatohet se kontratat e sipërmarrjes për ndërmjetësim lejesh ndërtimi lidhur midis shoqërisë {*} sh.p.k., dhe Znj. D. L nuk provojnë se sa kanë qenë përfitimet në asete në natyrë ose në likuiditete të Znj. D.L. Gjithashtu, është i paqartë përfitimi në masën 33.3 % i fitimit të shoqërisë {*} nga Znj. D. L (citurar në kontratat e ndërmjetësimit), pasi kjo e fundit nuk është aksionere në këtë shoqëri, por paraqitet vetëm si inxhinierë.
- 12.3.16** Referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” për ortakërinë, në rast të përfitimit të 33.3 % të aksioneve, siç edhe shprehet në kontratë, palët duhet të kishin krijuar një ortakëri të thjeshtë dhe duhet të kishin marrë një numër NIPT-i për këtë aktivitet, me qëllim deklarimin e të ardhurave nga ortakëria dhe pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e dhurueses, Znj. D. L, gjë që nuk na rezulton e provuar nga ana e subjektit.
- 12.3.17** Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të dhurueses dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokument provues që vërteton se këto të ardhura të jenë deklaruar dhe të jetë paguar detyrimi tatimor, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës, që përcakton se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*.
- 12.3.18** Për më tepër, Znj. D. L, në cilësinë e dhuruesit dhe të konfirmuar me anë të kontratës së dhurimit, ka pasur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij aseti të dhuruar, në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, i cili specifikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*, gjë e cila nuk është kryer.
- 12.3.19** Në lidhje me shpjegimet e subjektit se motra e tij, Znj. D. L, ka përfituar 33.3% duke ndërmjetësuar 12 leje ndërtimi nëpërmjet kontratave sipërmarrëse që mbajnë datat 04.12.2000 dhe 27.02.2006 dhe që i ka marrë përfitimet e saj në natyrë dhe likuiditete (para *cash*) nga shoqëria {*} dhe se shoqëria {*} ka marrë përsipër shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj shtetit (shih kontratat për ndërmjetësim, datë 04.02.2000 dhe datë 27.02.2006, bashkëngjitur), Komisioni arsyeton se nga dokumentacioni i dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk provohet nëse këto të ardhura janë marrë, kur dhe si janë marrë dhe, çfarë është më e rëndësishmja, nuk ka dokument që të vërtetojë nëse këto të ardhura janë deklaruar apo nëse janë paguar detyrimet tatimore. Komisioni ka vërtetuar me anë të shkresës së ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë se Znj. D. L rezulton ortakë në 5 shoqëri, por që nuk ka pasur të ardhura apo të ketë shpërndarë dividendë për këto aktivitete.
- 12.3.20** Për sa u përket bilanceve të shoqërisë {*} për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, që janë vënë në dispozicion nga subjekti, Komisioni nuk vërteton që të jetë pasqyruar përfitimi i 33.3% i të ardhurave nga Znj. D. L., kështu që këto dokumente nuk vërtetojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit.
- 12.3.21** Në lidhje me kontratat e shitblerjes të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe avokati i tij si burim financiar dhe shpjegimet se motra e subjektit të rivlerësimit, Znj. D. L., ka kryer dhe shitblerje me pronat e përfituara prej saj, ku dy të tilla i ka dërguar me e-mail (kontratë shitblerjeje për pasuri të paluajtshme me nr. 1445 rep., nr. 302/2 kol., datë 02.06.2016 dhe kontratë shitblerjeje me kusht, datë 24.10.2008, ku Znj. D. L ia shet apartamentin firmës {*} sh.p.k., me një vlerë prej 279.000 eurosh, shumë e cila do të paguhej pas çeljes së kredisë),

Komisioni arsyeton se, përveç faktit se këto kontrata nuk janë deklaruar si burim krijimi i këtyre pasurive nga subjekti, ato nuk citojnë nëse këto të ardhura të përfituara nga shitja e pasurisë janë deklaruar dhe nëse për këto është paguar tatimi përkatës sipas legjislacionit të kohës.

12.3.22 Në lidhje me deklaratat individuale vjetore për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të paraqitura nga avokati i subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore, si burim të ardhurash për dhuruesen D. L., Komisioni arsyeton se këto deklarata nuk provojnë burimin e ligjshëm të dhurueses, pasi nuk përputhen me kohën se kur janë bërë këto dhurata. Pra, dhurata njësi nr. 20, e quajtur zyrë, me sipërfaqe 172 m² dhe vlerë 120.000 euro, është shlyer në vitin 2009, provuar kjo me anë të kontratës së premtin-dhurimit nr. 1661 rep., nr. 622 kol., datë 15.03.2009, ku D. L pranon t'i dhurojë Z. Fatos Lulo një ambient me adresë Rruga {*}, Tiranë. Kontrata citon: Znj D. L i ka shlyer të gjitha detyrimet me shoqërinë {*}, pra i ka paguar kësaj shoqërie shumën 120.000 euro. Dhe dhurimi i shumës prej 100.000 USD është bërë në vitin 2008, provuar kjo me kontratën e dhurimit nr. 1369, nr. 547 kol., datë 21.02.2008, ku Znj. D. L i dhuron shumën 100.000 USD Z. Fatos Lulo. Pra, këto deklarata nuk provojnë burimin financiar të dhurueses, Znj. D. L.

12.3.23 Në lidhje me burimin financiar që deklarohet se është përdorur për blerjen e këtij apartamenti, pakësimit të shumës prej 100.000 USD dhuratë, konstatohet se ka deklarim të rremë. Kjo, e provuar me krahasimin midis deklaratës së interesave private “Deklarata e Pasurisë, Vetting 2017”, 04175/2017, dorëzuar më 30.01.2017, ku është deklaruar: “Burimi i të ardhurave të dhurueses Znj. D. L për dhuratat (Njësi nr. 20 me vlerë 120.000 euro dhe shuma *cash* prej 100.000 USD) është fitimi prej 33.3% nga kontratat e ndërmjetësimit të vitit 2000 dhe 2006 midis shoqërisë {*} sh.p.k., dhe Znj. D. L”, ndërsa në shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, më datë 28.02.2018, shtohen dhe 2 kontrata shitjeje si burim i të ardhurave dhe, më tej, avokati i subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 21.03.2018 paraqet si burim të ardhurash deklaratat individuale vjetore për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 të dhurueses, Znj. D. L.

12.3.24 Në lidhje me pakësimin e shumës prej 100.000 USD. Në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting” subjekti ka deklaruar se: “*Dhurimi në shumën prej 100.000 USD me kontratën nr. 1369 rep., dhe nr. 547 kol., datë 21.08.2008, nga motra ime D. L., e konsumuar në vitet 2008 - 2016*”, ndërsa në përgjigjen e pyetjes 7 të pyetësorit, dërguar më datë 22.12.2017, nr. 2175 prot., nga subjekti i rivlerësimit, ku kërkohet të jepen detaje mbi shkollimin e fëmijëve dhe nëse fëmijët studiojnë jashtë shtetit shqiptar, i është kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë detaje mbi pagesat për shkollimin dhe shpenzimet e jetesës, subjekti është përgjigjur se “...nga viti 2010, djemtë jetojnë dhe studiojnë njëri në Kanada e tjetri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe se burimi financiar i shkollimit janë paratë *cash* të dhuruara nga motra, Znj. D. L., në shumën 100 000 (njëqind mijë) USD, shumë e cila është konsumuar për jetesë, arsim dhe të tjera të kësaj natyre jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë”. Pra, siç edhe evidentohet, deklarimi nuk përputhet në kohë dhe për qëllimin që është konsumuar. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka dërguar asnjë dokument justifikues ligjor për shpenzimet për jetesë, shkollim dhe akomodim të fëmijëve në Amerikë dhe Kanada, edhe pse pyetja ishte e qartë.

12.3.25 Në lidhje me asetin ambient zyre, 74 m², Rr. {*}, pall. {*}, Tiranë, subjekti ka kryer deklarim të rremë pasi në “Deklaratën Para Fillimit të Detyrës, 2004” është deklaruar “*vlera 13.800.000 lekë, i pahirpotekuar, burimi- blerë nga aktiviteti si avokat*”, ndërsa në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting 2017” është

deklaruar “*në përdorim me të drejtë blerjeje në shumën 13.800.000 lekë*”, me anë të një kontrate të panoterizuar.

12.3.26 Në këto kushte, duke analizuar deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, raportin e ILDKPKI-së, shpjegimet dhe provat/dokumentet e paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe avokatit të tij, deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me anë të postës elektronike, si dhe provat shkresore të administruara në zbatim të nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni konkludon se Znj. D. L., në cilësinë e dhurueses së njësisë/zyrës nr. 20, me vlerë prej 120.000 eurosh dhe shumës *cash* prej 100.000 USD, të cilat janë deklaruar me anë të kontratave të dhurimit, nuk ka pasur të ardhura financiare të ligjshme në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që kanë shërbyer si burim për blerjen e njësisë nr. 20 në shumën 120.000 euro, që më pas i është dhuruar Z. Fatos Lulo, si dhe nuk ka pasur të ardhura prej 100.000 USD që më pas t’ia dhuronte subjektit të rivlerësimit. Znj. D. L., në cilësinë e huadhënësës së subjektit të rivlerësimit për shumën prej 480.000 USD dhe një zyre prej 74 m² me vlerë 13.800.000 lekë, të cilat janë deklaruar me anë të kontratës së huadhënies në vitin 2000 dhe kontratës së huapërdorjes në vitin 2002, nuk ka pasur të ardhura financiare të ligjshme në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që kanë shërbyer si burim për të siguruar 480.000 USD të ardhura dhe për blerjen e zyrës 74 m² dhënë në përdorim Z. Fatos Lulo me të drejtë parablerjeje.

12.3.27 Ndërsa në lidhje me mospërputhjet midis deklarinimeve të subjektit të rivlerësimit të pasqyruara më lart, Komisionin çmon se këto deklarinime të rreme cenojnë rëndë figurën dhe besueshmërinë e gjyqtarit kushtetues si funksion, duke përfaqësuar institucionin më të rëndësishëm të drejtësisë, i cili shërben si garant i Kushtetutës.

12.3.28 Në këto kushte, referuar pikës 3 të nenit 61, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12.3.29 Për deklaratën personale shtesë bashkëlidhur “Deklaratës së Pasurisë, Vetting, 2017”, në lidhje me deklarinimet e vitit 2004:

- i. Apartament banimi në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar. Burimi- blerë nga aktiviteti si avokat.
- ii. Depozitë jashtë vendit në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD. Burimi- nga puna në emigracion.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, ka administruar:

- i. Deklaratën personale shtesë të datës 30.01.2017, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit.
- ii. Deklaratën e pasurisë “Para Fillimit të Detyrës, 2004”. Formulari A-1, ku deklarohet apartament banimi në ndërtim, 150 m², vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar, në Toronto, Kanada; depozitë jashtë vendit 400.000 dollarë kanadezë në Toronto, Kanada, dhe marrjen hua të shumës prej 480.000 dollarësh amerikanë motrës.
- iii. Deklaratën e pasurisë, periodik, për vitin 2005, që mban datën 27.03.2006.
- iv. Deklaratën e pasurisë, periodik, për vitin 2006.

b. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 08.02.2018, të trupës gjykuese nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe, më datë 14.02.2018, njoftoi subjektin e rivlerësimit se mund të njihet me dokumentet e dosjes dhe se Komisioni ka arritur në përfundimin se provat e administruara në lidhje me këtë aset/pronë kanë nivelin e provueshmërisë, duke kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me deklarinimin se:

- i. Nuk e ka pasur ndonjëherë apartamentin e banimit në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, të pahipotekuar, blerë nga aktiviteti si avokat, megjithëse e ka deklaruar me vullnetin tuaj të lirë në vitin 2004.
- ii. Nuk e ka pasur ndonjëherë depozitën jashtë vendit në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me burim nga puna në emigracion, megjithëse e ka deklaruar me vullnetin tij të lirë, në vitin 2004.
- iii. Meqenëse subjekti deklaroi se nuk ka pasur ndonjëherë apartament, për rrjedhojë dhe shitja e apartamentit në Toronto, Kanada, në shumën 160.000 CAD, nuk ka ndodhur, megjithëse e ka deklaruar vetë në deklarinimin për vitin 2005 dhe 2006.
- iv. Meqenëse subjekti deklaroi se nuk ka pasur ndonjëherë depozitë në Kanada, për rrjedhojë mbyllja e depozitës në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me qëllim shlyerjen e huas nuk ka ndodhur, megjithëse e deklaroi vetë nga subjekti në vitin 2005 dhe 2006.

a. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 28.02.2018, dërgoi me anë të postës elektronike, shpjegimet e tij/provat në lidhje me këtë aset si më poshtë vijon:

Për sa u përket deklarinimeve të bëra në deklaratat periodike të vitit 2004, 2005, 2006 dhe në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting”, në lidhje me:

- i. Apartament banimi në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar. Burimi- blerë nga aktiviteti si avokat. (Deklarata 2004)
- ii. Depozitë jashtë vendit në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD. Burimi- nga puna në emigracion. (Deklarata 2004)
- iii. Shitja e apartamentit në Toronto, Kanada, në shumën 160.000 CAD. (Deklarata 2005, 2006)
- iv. Gjendja e depozitës në Kanada në shumën “0” (zero). Tërhequr shuma 400.000 CAD për shlyerjen e huas. (Deklarata 2005, 2006)
- v. Huaja marrë motrës, Znj. D. L, është shlyer plotësisht në shumën 480.000 USD, me shitjen dhe moshapjen e biznesit të planifikuar, si dhe nga puna e subjektit të rivlerësimit dhe mbyllja e depozitës, subjekti sqaron se ka depozituar pranë ILDKPKI-së një deklarinim të veçantë, që mban datën 21.01.2017.

12.3.30 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, duke pasur parasysh (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe avokati i tij gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

12.3.31 Deklarata personale shtesë e datës 21.01.2017, e dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit së bashku me “Deklaratën e Pasurisë, Vetting 2017”, përbën deklarinim të rremë, provuar kjo:

Në deklaratën e interesave private “Para Fillimit të Detyrës, 2004”, ku subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar edhe:

- i. Apartament banimi në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, të pahipotekuar. Burimi- blerë nga aktiviteti si avokat.
- ii. Depozitë jashtë vendit në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD. Burimi- nga puna në emigracion.

- iii. Hua marrë motrës, Znj. D. L, Rr. {*}, Tiranë, në shumën 480.000 USD, për blerjen e një shtëpie në Kanada, si dhe nisjen e një biznesi privat.

Ndërsa në deklaratën bashkëngjitur “Deklaratës së Pasurisë, Vetting 2017” ka deklaruar se asgjë që është deklaruar në 2004-n nuk është e vërtetë.

Në deklaratën e interesave private “Periodike/Vjetore 2005, 2006”, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar edhe:

- i. Shitja e apartamentit në Toronto, Kanada, në shumën 160.000 CAD.
- ii. Gjendja e depozitës në Kanada në shumën “0” (zero). Tërhequr shuma 400.000 CAD për shlyerjen e huas.
- iii. Huaja ndaj motrës, Znj. D. L, është shlyer plotësisht në shumën 480.000 USD, me shitjen dhe moshapjen e biznesit të planifikuar, si dhe nga puna dhe mbyllja e depozitës.

Ndërsa në deklaratën bashkëngjitur “Deklaratës së Pasurisë, Vetting 2017”, ka deklaruar se asgjë që është deklaruar në 2004 nuk është e vërtetë.

12.3.32 Në këto kushte, referuar pikës 3 të nenit 61, subjekti rivlerësimi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, çka do të thotë se subjekti i rivlerësimi ka bërë deklaram të rremë në lidhje me:

- i. Asetin apartament banimi në ndërtim, 150 m², Toronto, Kanada, vlera 14.200.000 lekë, i pahipotekuar, blerë nga aktiviteti si avokat, pasi subjekti ka deklaruar se këtë aset nuk e ka pasur ndonjëherë.
- ii. Depozitën jashtë vendit në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me burim nga puna në emigracion, pasi subjekti ka deklaruar se këtë likuiditet nuk e ka pasur ndonjëherë.
- iii. Qëllimin dhe përdorimin e kësaj shume.
- iv. Shitjen e apartamentit në Toronto, Kanada, në shumën 160.000 CAD, pasi subjekti ka deklaruar se këtë aset nuk e ka pasur ndonjëherë.
- v. Mbylljen e depozitës në Toronto, Kanada, në shumën 400.000 CAD, me qëllim shlyerjen e huas, pasi subjekti ka deklaruar se këtë aset nuk e ka pasur ndonjëherë.
- vi. Shlyerjen e huas motrës, Znj. D. L., në shumën 480.000 USD, deklaruar me shitjen dhe moshapjen e biznesit të planifikuar, nga puna dhe mbyllja e depozitës në Toronto, Kanada, ndërkohë që subjekti ka deklaruar se biznesi nuk u hap ndonjëherë dhe depozita në Toronto, Kanada, nuk ka ekzistuar ndonjëherë.

12.4 ARSYETIMI LIGJOR DHE ANALIZA E ASETEVE DHE TË ARDHURAVE SË BASHKU

Janë përmbledhur të gjitha asetet dhe të ardhurat e deklaruara së bashku nga Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimi në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimi Kalimtar, Vetting 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimi dhe avokati i tij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (iv) deklaramet e subjektit të rivlerësimi me anë të postës elektronike; (v) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit 84/2016, me qëllim që të kuptohet më qartë raporti midis aseteve të deklaruara dhe të ardhurave të ligjshme. Më poshtë do t’i gjeni të paraqitura në mënyrë tabelore:

- i. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimi dhe personat e lidhur, të ardhurat e ligjshme sipas analizës së kryer veç për secilën të ardhur, si dhe të ardhurat e pajustificuara, janë si më poshtë:

Punësimi/angazhimi	Të ardhurat e deklaruara	Të ardhurat e ligjshme
Subjekti i rivlerësimit		
Jurist në organe të ndryshme shtetërore	90.000 Lekë	90.000 Lekë
Aktiviteti si avokat për vitet 1995 - 1999 dhe vitet 2002 -2005	10.500.000 Lekë	4.170.100 Lekë
Anëtar i Gjykatës së Lartë (2006 - 2013)	11.938.448 Lekë	11.938.448 Lekë
Anëtar i Gjykatës Kushtetuese (2013 - janar 2017)	6.997.637 Lekë	6.997.637 Lekë
Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit		
Punësim pranë Akademisë së Shkencave për vitet 1994 -1998 dhe 2002 -2008	5.997.600 Lekë	5.997.600 Lekë
Mësuese në shkollën “Faik Konica” për vitet 2014 -2015	270.000 Lekë	270.000 Lekë
Të ardhura nga shitja e apartamentit në adresën{*}	5000 USD	5000 USD
Totali i të ardhurave të ligjshme (subjekti +bashkëshortja):		30.100.635 Lekë

Tabelë nr. 2 - Të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, të ardhurat e ligjshme sipas analizës së kryer veç për secilën të ardhur, si dhe të ardhurat e pajustificuara

- ii. Pasuritë e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting 2017” dhe deklaratat e pasurive ndër vite të subjektit të rivlerësimit, si më poshtë:

Përshkrimi i aseteve	Vlerat e deklaruara	Vitet e deklarimit
Apartament banimi, 112 m ² , në Tiranë	9.300.000 Lekë	Deklarata, Vetting 2017
Apartament banimi, në Kanada, 150 m ²	14.200.222 Lekë	Deklaratat e viteve 2004, 2005, 2006
Ambient zyre, 74 m ² , (dhënë me huapërdorje nga motra, me të drejtë shitjeje)	13.800.000 Lekë	Deklarata, Vetting 2017
Para <i>cash</i> të dhuruara nga motra, 100.000 USD ¹	8.303.000 Lekë	Deklarata, Vetting 2017
Depozitë në Kanada, 400.000 CAD ²	33.104.000 Lekë	Deklaratat e viteve 2004, 2005, 2006
Totali i pasurisë së deklaruar	78.707.222 Lekë	

Tabelë nr.3- Pasuritë e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë, Vetting 2017” dhe deklaratat e pasurive ndër vite të subjektit të rivlerësimit

12.4.1 Referuar përmbledhjes tabelare më lart, konfirmuar dhe nga ILDKPKI-ja me anë të shkresës nr. 4021/1prot. datë 30.11.2017, për të ardhurat dhe asetet, totali i pasurisë së deklaruar është 78.707.222 lekë, ndërsa të ardhurat e ligjshme janë 30.100.635 lekë, duke përbërë kështu dyfishin e pasurisë së ligjshme, përfshirë dhe personat e lidhur.

12.4.2 Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, referuar pikës 1 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar sa dyfishi i pasurisë së ligjshme, përfshirë dhe personat e lidhur me të.

12.5 BASHKËPUNIMI I SUBJEKTTIT TË RIVLERËSIMIT GJATË HETIMIT, SIPAS NENIT 48 TË LIGJIT NR. 84/2016

Gjatë të gjitha fazave të hetimit, ky Komision ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues gjatë

¹ Konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007

² Konvertuar në lekë me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë

gjithë procesit në lidhje me gatishmërinë për të kthyer përgjigje, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

12.6 KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Në përfundim të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar analizës së sipërcituar për pasuritë dhe të ardhurat, veç e veç, si dhe të marra së bashku, konkludon se subjektit të rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" dhe në nenin 61, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Z. Fatos Lulo, gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 23.03.2018.

Kryesuese
Genta TAFA (BUNGO)
(Firma)

Anëtare
Brunilda BEKTESHI
(Firma)

Relatore
Etleda ÇIFTJA
(Firma)

Sekretare gjyqësore
Anisa DUKA
(Firma)